



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 8, paragrafi 1, pika 1.2, e konform nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 25.04.2019, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Shoqatës bëmirëse “**Jetimat e Ballkanit**”, me seli në Komunën e **Prizrenit, Rr. “Bekim Muhaxheri” Nr. 18**, të cilën e përfaqëson **Berat Kabashi-Përfaqësues i autorizuar i organizatës: I jepet** në shfrytëzim afatgjatë deri në **50, (pesëdhjetë) vite**, parcela kadastrale **P72116020-00917-0**, sipas certifikatës së pronës, Nr-11-463-109-2019, e cila gjendet në vendin e quajtur “Livadhi verdh” në fshatin Gjinoc Komuna e Suharekës, me sipërfaqe prej **12435m²** dhe **objekti** që është në ndërtim e sipër me sipërfaqe të përgjithshme të bazamentit 1,320m² pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, me destinim të caktuar **“Ofrimin e shërbimeve për personat pa përkujdesje familjare”** sipas rekomandimit 01-Nr-016-23232 të datës 05.04.2019, të komisionit për zhvillimin e procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **25.04.2019**, dhe përfundon afati më datën, **24.04.2069**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik i pronës.

Neni 3

3.1 Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekës të nënshkruan kontratë me fituesin, me anë të së cilës i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 4

4.1 Obligohet shfrytëzuesi i cekur në nenin 1, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t’ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t’i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-27902
Më datë 25.04.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bekhet KUÇI